



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Prishtinë, 30.08.2023

DORACAK PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE REKLAMUESE NË LED PËR KLUBET E PRINCE CAFFE SUPERLIGËS SË KOSOVËS NË BASKETBOLL

Me qëllim të rritjes së vlerës së garës së Prince Caffè Superligës së Kosovës, por edhe rritjes së vlerës dhe përkrahjes së klubeve anëtare të saj, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vendosur që të sigurojë praninë e sistemit më të avancuar të reklamimit LED në të gjitha palestrat sportive ku zhvillohen ndeshjet e elitës së basketbollit kosovar.

Si rrjedhojë, Federata e Basketbollit të Kosovës do të merr përsipër pagesën e shpenzimeve të sistemit LED në emër të klubeve anëtare të Prince Caffè Superligës së Kosovës, ndërsa ekipet duhet të sigurojnë hapësirën në palestër për vendosjen e tyre dhe të asistojnë për vendosjen e sistemit LED me kapacitetet e tyre njerëzore, si dhe të garantojnë qasje të papenguar nëpër palestra dhe stabilimente të tyre për ekipin realizues të kontraktuar për vendosjen e sistemeve LED.

Ekipet nikoqire do të jenë përgjegjëse për hyrjen dhe daljen e sigurt të ekipeve realizuese dhe për sigurinë e sistemeve të kushtueshme LED gjatë kohës së vendosjes në palestrën nikoqire.

Ekipet pjesëmarrëse do të jenë përgjegjëse për dëmtimin e sistemeve LED nga cilido anëtar apo tifoz i tyre. Pas çdo ndeshje, dëmet materiale në sistemin e LED do dokumentohen nga personat zyrtarë të ndeshjeve në FBK (foto, video) dhe dërgohen tek FBK nga ekipi i kontraktuar për vendosjen e sistemeve LED (dhe nga delegati/vëzhguesi i ndeshjes kur ekziston mundësia), e më pas FBK do përcjell këtë raport tek klubet së bashku me obligimet tjera financiare për xhiron përkatëse, në mënyrë që të bëhet kompensimi i dëmit të shkaktuar.

Vendosja e sistemeve të reklamimit LED për të gjitha ndeshjet e Prince Caffè Superligës përbën krijimin e një standardi të ri organizativ për garën e nivelit elitë.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Për të realizuar këtë sipërmarrje madhore dhe të rëndësishme për imazhin dhe nivelin e basketbollit elitare në vendin tonë, Federata e Basketbollit të Kosovës do të caktojë një person kontaktues për reklamat, të cilat klubet do t'i vendosin në sistemin LED, kurse të njëjtën gjë duhet ta bëjnë edhe klubet, pra ta caktojnë një person kontaktues për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me personin e emëruar nga FBK. Ekipet e Prince Caffè Superligës duhet t'i dërgojnë më së largu dy ditë para ndeshjeve reklamat e tyre që do ti vendosin në sistemin LED, në formatin grafik të kërkuar nga FBK dhe operatori i kontraktuar për këtë qëllim nga FBK. Klubeve të Prince Caffè Superligës së Kosovës do t'ju ndahet tabela orientuese e reklamimit në sistemin LED, në të cilën duhet të identifikojnë të gjithë sponsorët që do të reklamohen në të.

Hapësira reklamuese në sistemin LED do të ndahet mes ekipeve nikoqire dhe FBK, në proporcionin e përcaktuar nga FIBA për garat elitare të saj. Klubet nikoqire do të kenë të drejtë të vendosjes së deri në 16 logo të sponsorëve të tyre, përfshirë edhe logot e komunave përkatëse në rast se të njëjtat përkrahin veprimtarinë e klubeve, ndërsa FBK ruan të drejtën e vendosjes së 8 reklamave të veta pas çdo rotacioni të 16 reklamave të ekipit nikoqir. Reklamat do të jenë të ndara mes vete me logot përkatëse të FBK-së dhe klubit nikoqir.

Shembull i një rotacioni në LED – 28 pozicione:

1. Intro klubi nikoqir	2. Sponsor	3. Intro FBK
4. Sponsor	5. Sponsor	6. Sponsor FBK
7. Sponsor	8. Sponsor	9. Sponsor FBK
10. Sponsor	11. Sponsor	12. Sponsor FBK
13. Sponsor	14. Sponsor	15. Sponsor FBK
16. Sponsor	17. Sponsor	18. Sponsor FBK
19. Sponsor	20. Sponsor	21. Sponsor FBK
22. Sponsor	23. Sponsor	24. Sponsor FBK
25. Sponsor	26. Outro klubi nikoqir	27. Sponsor FBK
		28. Outro FBK

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Me respekt,

Elvira DUSHKU
Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës



Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

